

STATUTI  
I  
SHOQËRISË

MobilYacht SH.P.K.

Sot, më datë 07.02.2021

**Z. Ismet Sadikaj** i d. 26.09.1970, lindur ne Zogaj, Tropoje dhe banues ne Durrës, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me ane te Pasaportes shqiptare me Nr. personal H00926137R dhe Nr.BF3161975.

Ka vendosur themelimin e Shoqërisë **MobilYacht Sh.p.k.**, me termat si më poshtë:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare **MobilYacht Sh.p.k.** rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, (në vijim **Shoqëria**).

**NENI 1.**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i Aktivitetit (fusha e veprimtarise) :

Import - eksport, tregtimin, prodhimin, përpunimin, lyerjen dhe montimin e mobiljeve te ndryshme të të gjitha llojeve dhe materialeve qe perdoren per mobilje kryesisht ato të drurit per anije, jahte dhe çdo lloj mjeti tjeter lundrues si dhe per objekte banimi, bisnesi etj, brenda dhe jashtë vendit.

Aktivitet ne fushen e regjimit te perpunimit aktiv ( Fason).

Tregtim me pakicë e shumicë të gjitha punimeve e prodhimeve të llojeve të drurit, të llojeve të duroalumineve, të xhamit, brenda e jashtë vendit. Prodhim e tregtim të dyerve të blinduara. Projektim, ndërtim të objekteve social kulturore ekonomike, industriale, objekte banimi si dhe prodhim e tregtim të materialeve të ndërtimit, inerte etj. Sipërmarrje punime ndërtimi-montimi, elektrike, hidraulike, hidrosanitare etj. Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, lëndë të para të llojeve të ndyshme, pijë,



veshmbadhje e konfeksione, hidrosanitare, kancelari për zyra e shkolla, mobilje e orendi shtëpiake, pajisje elektrike, elektronike, elektroshëpiake, pjesë këmbimi për makineri, automjete, makineri të ndryshme industriale, teknologjike e mjete trasporti produkte bujqësore, blegtorale, fruta perime, produkte të detit, bimë medicinale e eterovajore e mjekësore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjentë, hidraulike, elektrike, hidrosanitare, druri e prodhimet e drurit, hekuri si dhe të gjitha llojeve të tjera të mallrave, shërbimeve dhe pasurive të luajtshme e paluajtshme, të shërbime në transportin e mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit, të financimeve dhe transaksioneve të ndyshme financiare, Hoteleri, turizëm, bar 2 kafe, restorant. Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve publike dhe private në pronësi ose përdorim të personave fizik e juridik, shërbimi i ruajtjes dhe sigurimit fizik në mbrojtje të shëndetit dhe jetës të personave shtetas vendas dhe të huaj. Të zhvillojë aktivitetin në fushën e grumbullim, përpunim dhe tregtim të produkteve blektorale dhe frutave të pyllit. Dhënie së konsulencës teknike, ndërmjetësim tregtar, studim tregu, studim legjislacioni në lidhje me industrinë e drurit dhe prodhimet e tij si dhe dhënies së konsulencës dhe kryerjes së shërbimeve të ndryshme, të organizimit dhe prodhimit të mallrave artizanale, zhvillimit të kurseve të formimit profesional për përpunimin e drurit. Agroturizëm. Prodhim, kultivim dhe tregtim të perimeve dhe frutave në serë dhe fushë të hapur.

Për të vetmin qëllim të arrijes së objektit të lartpërmendur, shoqeria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqeri të tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngashem apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Ne vecanti, shoqeria, mund te marre ne pronesi, uzufrukt ose qera, kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimitarive te mesiperme.

## NENI 2

### Selia e Shoqërisë

Shoqeria e ka seline **LIGJORE : Durres, Rrashbull, Vrrine, Rruga Nacionale Rrashbull-Sektor Rinia,Zona Kadatrale 3339, Godine me Nr.Pasurie 19/27.**

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

## NENI 3

### Kohëzgjatja e Shoqërisë.



Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### NENI 4.

##### **Regjimi juridik i Shoqërse**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimitaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

#### **II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.**

##### NENI 5.

Ortaku nuk mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhin në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

##### NENI 6

##### **Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.**

Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informon ortakun për securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do t'u përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.



Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria dhe të shese pjesën e tij të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Hecja dorë nga shoqëria nuk i liron ate nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortaku vepron, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpinqet për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

#### NENI 7.

##### **Abuzimi i ortakut ndaj shoqërisë**

Ortaku i shoqërisë tregtare, që kryen një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjet personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij nëse:

- a) abuzon me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajton pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuria e tij;
- c) në çastin kur merr apo duhet të kishte marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk merr masat e nevojshme, për të siguar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

#### **III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**

#### NENI 8.

Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë e të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

#### NENI 9.

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 (njeqindmije) lekë dhe përbehet nga 1(nje) kuote.

**Z.Ismet SADIKAJ**, është zotërues i 1 kuote, me 100 % pjesmarje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

#### NENI 10,



## **Pronësia mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

### **NENI 11.**

#### **Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.**

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

### **NENI 12.**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme me 3/4 e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakut.

### **NENI 13.**

#### **Fondet rezerve**

Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

### **NENI 14.**

#### **Përdorimi i të ardhurave neto.**

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditin për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortaket sipas qëllimeve të tyre.

### **NENI 15.**

#### **Bilanci, plani finanziar.**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakut ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.



Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finansiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

#### NENI 16.

##### Shpërndarja e fitimeve

Ortaket kane të drejtë të ndaje pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi i shpërndahet ortakut në raport me kuotat e zotëruara.

#### NENI 17.

##### Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitimin ortakeve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividentëve përmbrush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbrush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortaku, që ka marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u eshte shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, ky ortak ka patur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për këtë gjendje.

#### IV. ORGANET E SHOQËRISË.

#### NENI 18.

##### Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  e votave në rastet e mëposhtme:



1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

- 1 Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 2 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 3 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- 4 emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- 5 emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 6 përcaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- 7 mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- 8 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 9 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

#### NENI 19.

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.



- Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asamblea e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## NENI 20.

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## NENI 21.

### Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.



Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

#### NENI 22.

##### **Proçesverbali i mbledhjes se asamblesë**

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

#### **V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

##### NENI 23.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i Emerimit i Administratoreve nuk mund te jete me shume se 5-vjet, me te drejte riemerimi. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të caktojë rregulla të posacme për emerimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administrator i Shoqërisë do të jetë: **Z. Ismet Sadikaj, per një periudhe 5-vjecare.**

Shoqëria do të përfaqësohet përpëra ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratorët e shoqërisë, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

##### NENI 24.

##### **Të drejtat dhe kopetencat e administratorit**

Administratori ka të drejtë të:

1. Te kryej veprime te administrimit të shoqerise.
2. Te kryej te gjitha aktet administrative te shoqerise, duke zbatuar politikat tragtare te caktuara nga asambleja e përgjithshme;



3. përfaqësojë shoqerinë tregtare;
4. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
5. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpérndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
6. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
7. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
8. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
9. kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

### NENI 25.

Shoqëria prishet në rast kur:

1. kur mbaron kohëzgjatja e themelimit të saj;
2. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
3. në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqerisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
4. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
5. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
6. për cdo shkak tjeter të vendosur nga asambleja e ortakeve, etj.



Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

#### NENI 26.

##### Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqerinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimii "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

#### NENI 27.

##### Të drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre



pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

#### NENI 28.

##### Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### NENI 29.

##### Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

#### VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

##### NENI 30.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

##### NENI 31.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi sht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### ORTAKU THEMELUES

Ismet Sadikaj

